



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 qershor 2015
Nr. ref.: RK 807/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI174/14

Parashtrues

Rrahim Pacolli

Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14 të Ligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës, Nr. 03/L-179

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar,
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Rrahim Pacolli me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili është drejtor i “Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës”.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 14 të Ligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës, Nr. 03/L-179, i cili është miratuar në Kuvendin e Kosovës më 10 qershor 2010, i shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. DL-025-2010, më 2 korrik 2010, dhe i publikuar në Gazetën zyrtare më 20 korrik 2010.
3. Gjkata Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata) vëren se tashmë kishte vendosur për objektin e njëjtë të çështjes në Rastin KI118/10, ku parashtrues i kërkesës ishte “Shoqata e Sigurimeve në Kosovë”. Në atë rast, më 13 dhjetor 2010, Gjykata kishte refuzuar kërkesën për vendosjen e Masës së përkohshme dhe më 23 maj 2011, ajo kishte nxjerrë Aktvendim për papranueshmëri. Parashtruesi i tanishëm, z. Rrahim Pacolli, është drejtor i të njëjtës Shoqatë të Sigurimeve.

Objekti i çështjes

4. Parashtruesi i kërkesës pretendon se neni i kontestuar, pra neni 14 i Ligjit është në kundërshtim me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 10 [Ekonomia], nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
5. Parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata të vendosë Masë të përkohshme për të ndaluar zbatimin e nenit 14 nga data e parashtrimit të kërkesës, e deri në marrjen e vendimit meritor nga Gjykata për këtë çështje.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 2 dhjetor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
8. Më 17 dhjetor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI174/14, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI174/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
9. Më 23 dhjetor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 3 shkurt 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 2 dhjetor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën KI174/14 në Gjykatë, duke pretenduar shkelje të Kushtetutës.
12. Megjithatë, më 26 nëntor 2010, “Shoqata e Sigurimeve në Kosovë”, kishte dorëzuar një kërkesë identike në Gjykatë, duke e kontestuar të njëjtin nen të Ligjit për Kryqin e Kuq (neni 14 i Ligjit), dhe duke kërkuar nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme që ta pezullojë nenin e kontestuar të Ligjit, derisa të merret vendimi për rastin.
13. Përveç kësaj, Shoqata e Sigurimeve pretendoi se neni i kontestuar i Ligjit kishte shkelur nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 10 [Ekonomia], nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit].
14. Në atë rast, më 13 dhjetor 2010, Gjykata refuzoi kërkesën e Shoqatës së Sigurimeve për vendosjen e Masës së përkohshme me arsyetimin: *“Një nga kriteret për lejimin e Masës së përkohshme është nëse do të shkaktohen dëme të pariparueshme. Nëse Gjykata Kushtetuese në fund gjen që Neni 14 është jo kushtetues, atëherë çfarëdo dëmi i shkaktuar qoftë ndaj parashtruesit apo kompanive individuale të sigurimeve mund të llogaritet dhe nëse është e nevojshme mund të urdhërohet kthimi i këtyre fondeve nga gjykata përkatëse. Nuk ka asgjë të pariparueshme në dëmin e shkaktuar. Parashtruesi nuk e ka dëshmuar që kompanitë e sigurimeve Illyria, Siguria dhe Sigkos, apo ndonjë kompani tjetër e sigurimeve, do të falimentojë si rezultat i zbatimit të tarifës prej 1%. Prandaj, nga kjo bazë nuk mund të argumentohet caktimi i Masës së përkohshme të kërkuar”*.
15. Më 23 maj 2011, Gjykata e hodhi poshtë kërkesën e Shoqatës së Sigurimeve në Rastin KI118/10 si të papranueshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës. Gjithashtu hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për vendosjen e Masës së përkohshme.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës konsideron se neni 14 i Ligjit për Kryqin e Kuq Nr. 03/L-179, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës është tërësisht jokushtetues dhe në kundërshtim me nenet 3, 24 dhe 49 të Kushtetutës.
17. Parashtruesi kërkon nga Gjykata të:
“[...]”
 - a) *“APROVOHET kërkesa për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë të Shoqatës së Kompanive të Sigurimeve të Kosovës.*
 - b) *ANULOHET neni 14 pika 1.7., i Ligjit Nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës, si jokushtetues.*
 - c) *CAKTOHET masa e përkohshme e zbatimit të nenit 14 pika 1.7., të Ligjit Nr. 03/L-179 Për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës, nga*

dita e parashtrimit të kërkesës e deri me marrjen e vendimit meritator nga ana e Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me këtë çështje që është objekt i procedurës”.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore.

19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116.1 të Kushtetutës [Efekti Juridik i Vendimeve], i cili përcakton:

“Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës”.

20. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 63 (1) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“Vendimet e Gjykatës janë të obligueshme për gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës”.

21. Për më tepër, rregulli 36 (3) (d) i Rregullores së punës, përcakton:

“Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:

[...],

(d) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri”

22. Gjykata rikujton se ajo tashmë e ka trajtuar objektin e çështjes së kërkesës së tanishme në Rastin KI118/10, në të cilin parashtrues i kërkesës ishte “Shoqata e Sigurimeve në Kosovë”. Më 23 maj 2011, ajo e refuzoi atë rast si qartazi të pabazuar, sepse Kushtetuta e Kosovës nuk parasheh *actio popularis*, e cila ua mundëson individëve iniciimin e vlerësimit abstrakt, pavarësisht nga interesi i veçantë ligjor i tyre në këtë çështje.

23. Prandaj, Shoqata e Sigurimeve në Rastin KI118/10 nuk ka mundur të konsiderohet si palë e autorizuar, e cila mund të iniciojë çështje kushtetuese në abstrakt në lidhje me vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 14 të Ligjit Nr. 03/L-179, duke kërkuar të merr një mjet juridik në emër të interesave kolektive.

24. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se ajo tashmë ka vendosur për objektin e çështjes të kërkesës së tanishme, i cili nuk përmban asnjë bazë për një vendim të ri.

25. Prandaj, në pajtim me nenin 116.1 të Kushtetutës, rregullin 63 (1) dhe 36 (3) (d) të Rregullores së punës, Gjykata konkludon se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme.

Vlerësimi i kërkesës për Masë të përkohshme

26. Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesë kërkon që Gjykata të vendosë Masë të përkohshme, për ndalimin e zbatimit të nenit 14 të Ligjit për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-179, nga data e parashtrimit të kërkesës e deri në marrjen e vendimit meritator nga Gjykata Kushtetuese, lidhur me këtë çështje që është objekt i procedurës.
27. Për të aprovuar kërkesën për Masë të përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, Gjykata duhet të përcaktojë që:
- “(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës:*
 - (b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme;*
 - (c) Masa e përkohshme është me interes publik”.*
28. Siç është konkluduar më lart, kërkesa është e papranueshme, dhe prandaj nuk ka rast *prima facie* për vendosjen e Masës së përkohshme. Për këto arsye, kërkesa për Masë të përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 55 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 22 qershor 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof, dr. Enver Hasani

